



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**  
**Nr. 1435, datë 02.11. 2010**

**Për**

**“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me Vendimin nr.1353, datë 06.08.2010 për zgjidhjen e mosmarrevëshjes mbi përfundimin e afatit të vlefshmërisë dhe rinovimin e marrëveshjes së interkoneksionit midis Altelecom sh.a dhe Albanian Mobile Communications sh.a”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 02.11. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbylljen e procedimit administrative të filluar me Vendimin nr.1353, datë 06.08.2010 për zgjidhjen e mosmarrevëshjes mbi përfundimin e afatit të vlefshmërisë dhe rinovimin e marrëveshjes së interkoneksionit midis Altelecom sh.a dhe Albanian Mobile Communications sh.a, të shoqëruar nga:

- Raport përmbledhës (**Raporti**);
- Projekt Vendim i KD ( **Projektakti**);
- Dokumentet shkresore të palëve (**Provat, pretendimet**);

## BAZA LIGJORE :

1. Neni 120, i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
2. Nenet 66-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore Nr.18, datë 11.06.2010 “Per procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”;
4. Rregullore Nr.19, datë 14.06.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, e ndryshuar,
5. Pika 17 e nenit 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP (Rregullorja e Brëndshme), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918.

## K Ë SHILL I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, te përbërë nga:

1. Vendimin nr.1353, datë 06.08.2010 për “Fillimin e procedimit administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes mbi perfundimin e afatit të vlefshmerise dhe rinovimin e marrëveshjes se interkoneksionit midis Albtelecom sh.a dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”;
2. Shkresë e AKEP nr. 2481/2 prot, date 11.08.2010 “Njoftim Vendimi nr. 1353 date 06.08.2010 te KD te AKEP”, drejtuar sipermarrësve Albanian Mobile Communications sh.a dhe Albtelecom sh.a;
3. Shkresë e AKEP nr. 2297/9 prot, datë 18.08.2010 drejtuar AMC dhe për dijeni Albtelecom “Mbi rilidhjen e qarqeve të interkoneksionit mes AMC sh.a dhe Albtelecom sh.a”;
4. Shkresë e AMC sh.a nr. 3341/4 prot, datë 24.08.2010 (AKEP: nr. 2481/3 prot, datë 24.08.2010), “Përgjigje mbi kërkesën e Vendimit nr. 1353 date 06.08.2010 mbi fillimin e procedimit administrativ per Albtelecom sh.a” (Bashkelidhur gjendet korrespondenca me email mbi amendamentin nr.1 te MI midis paleve);
5. Shkresë e Albtelecom nr. 3758/1 prot, date 24.08.2010 (AKEP: nr. 2481/5 prot, datë 24.08.2010), “Mbi depozitimin e pretendimeve te Albtelecom lidhur me mosmarrëveshjen me AMC për përfundimin e afatit të vlefshmërisë dhe rinovimin e marrëveshjes së interkoneksionit”, (Bashkelidhur gjendet korrespondenca mbi amendamentin nr.1 te MI midis paleve);
6. Shkresë e Albtelecom nr. 3069/1 prot, date 24.08.2010 (AKEP: nr. 2481/4 prot, datë 24.08.2010), drejtuar AMC për dijeni AKEP “Përgjigjes Tuajës nr. 3341/2, dt. 09.07.2010 “Mbi amendimin e MI mes Albtelecom sh.a dhe AMC sh.a”;

7. Shkresë e Albtelecom nr. 2885/7prot, date 27.08.2010 (AKEP: nr. 2297/11 prot, datë 27.08.2010) drejtuar AKEP “Mbi bllokimin e mëtejshëm të qarqeve të interkoneksionit nga ana e AMC”;
8. Shkresë e AMC me nr. 1054/12 Prot, dt 03.09.2010 (AKEP: nr. 2297/13 Prot, dt 06.09.2010) drejtuar AKEP;
9. Shkresë e AMC nr.1054/14 datë 14.09.2010 (AKEP: 2297/14 prot, datë 14.09.2010) drejtuar AKEP;
10. Shkresë e Albtelecom nr. 2885/8 prot, dt. 17.09.2010 ( AKEP: 2297/15 prot, dt. 17.09.2010) “Mbi zhbllokimin e qarqeve te interkoneksionit nga ana e AMC”;
11. Shkresa e AMC 1054/5 prot, datë 17.09.2010 (AKEP: nr. 2297/16 prot, datë 20.09.2010), drejtuar AKEP “Pagesa e detyrimeve të pashlyera të Albtelecom ndaj AMC”
12. Shkresë e Albtelecom nr. 2885/9 prot, dt. 20.09.2010 ( AKEP: 2297/17 prot, dt. 20.09.2010) “Mbi riperseritjen e sjelljeve abuzive nga ana e AMC”;
13. Shkresë e Albtelecom nr. 4316 prot, dt. 21.09.2010 ( AKEP: 2297/18 prot, dt. 21.09.2010) “Njoftim per shkelje”;
14. Shkresa e AMC 1054/17 prot, datë 24.09.2010 (AKEP: nr. 2297/19 prot, datë 24.09.2010), “Përgjigje letës suaj me subjekt njoftim për shkelje”, drejtuar Albtelecom per dijeni AKEP;
15. Shkresa e AMC nr. 1054/18 prot, datë 24.09.2010 (AKEP: nr. 2297/20 prot, datë 27.09.2010) , drejtuar AKEP;
16. Shkresë e Albtelecom nr. 4376/1 prot, dt. 28.09.2010 ( AKEP: 2895/9 prot, dt. 28.09.2010) drejtuar AMC per dijeni AKEP “Përgjigje Tuajes nr. 4493 dt. 01.09.2010 mbi aplikimin e tarifave për shërbimin e interkoneksionit ne zbatim të vendimit nr. 1345 datë 23.07.2010”
17. Albtelecom me shkresën nr.4316/2 prot, datë 04.10.2010 ( AKEP: nr. 2297/21 prot, date 04.10.2010) “Njoftim per shkelje” drejtuar AMC, per dijeni AKEP.
18. Shkresë e Albtelecom nr. 2885/10 prot, dt. 05.10.2010 ( AKEP: 2897/22 prot, dt. 05.10.2010) drejtuar AKEP “Kërkohet shqyrtim i kërkesës se Albtelecom drejtuar AKEP me shkresën nr. 2885/9 prot, datë 20.09.2010;
19. Shkresë e Albtelecom nr.4076/2 prot, datë 05.10.2010 ( AKEP: nr. 2895/10 prot, date 05.10.2010) “Në vijim tonës nr. 4076/1 prot, dt. 28.09.2010” drejtuar AMC, per dijeni AKEP;
20. Shkresë e AMC nr. 4493/3 prot, datë 07.10.2010 ( AKEP: nr. 2895/11 prot, datë 07.10.2010), “Përgjigje letres Tuaj nr. 4076/2 prot, date 05.10.2010”, drejtuar Albtelecom per dijeni AKEP;
21. Shkresë e AKEP nr. prot, date .2010 “Njoftim per seance degjimore për zgjidhjen e mosmarveshjes mbi perfundimin e afatit te vlefshmerise dhe rinovimin e marrëveshjes së interkoneksionit midis Albtelecom sh.a dhe Albanian Mobile Communications sh.a, drejtuar sipërmarresve te mesipërm;

22. Proces verbali i mbajtur nga seanca dëgjimore midis palëve me 05.10.2010;
23. Shkresë e Albtelecom nr.4696, datë 15.10.2010 (AKEP: nr. 2297/23, datë 18.10.2010) “Mbi shtim objekti për mosmarrëveshjen me AMC lidhur me rinovimin e MI dhe dërgimin e provave shkresore në vijim të seancës dëgjimore mbajtur në AKEP në kuadër të VKD 1353 dt. 06.08.2010”;
24. Projektvendim i KD te AKEP per “Mbylljen e procedimit administrative të filluar me Vendimin nr.1353, datë 06.08.2010 për zgjidhjen e mosmarrëveshjes mbi perfundimin e afatit te vlefshmerise dhe rinovimin e marrëveshjes së interkoneksionit midis Albtelecom sh.a dhe Albanian Mobile Communications sh.a, (**Projektvendimi**);
25. Raport permbledhes mbi projektvendimin (**Raport** );  
*si dhe*
26. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen;
27. Bazës ligjore të sipërcituar,

#### V Ë R E N se:

- I. Bazuar në pikën 2 të Vendimit nr. 1353, datë 06.08.2010, “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes mbi përfundimin e afatit të vlefshmerisë dhe rinovimin e marrëveshjes së interkoneksionit midis Albtelecom sh.a dhe Albanian Mobile Communications sh.a”, për depozitimin e pretendimeve me shkrim deri më dt. 24.08.2010,
1. **AMC sh.a** me anë të shkresës nr. 3341/4 prot, datë 24.08.2010 (AKEP: nr. 2481/3 prot, datë 24.08.2010), “Përgjigje mbi kërkesën e Vendimit nr. 1353 date 06.08.2010 mbi fillimin e procedimit administrativ per Albtelecom sh.a” (Bashkelidhur gjendet korrespondenca me email mbi amendamentin nr.1 te MI midis paleve), sqaron se:
  - Marrëveshjet e Interkoneksionit (me poshte MI) me Albtelecom janë nënshkruar çdo vit mbi bazën e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi ne RSH;
  - AMC ka lidhur MI nr. 434 date 29.07.2009 me Albtelecom sh.a, e cila i ka filluar efektet e saj më datë 1.04.2009 me kohëzgjatje deri më 31.03.2010;
  - MI me Albtelecom në zbatim të pikës 21.2 te saj i ka shtrirë efektet e saj juridike deri më 30.06.2010;
  - AMC ka zhvilluar dy takime me Albtelecom dhe në të dy takimet është rënë dakort për amendimin e marrëveshjes së interkoneksionit midis dy kompanive dhe për shtrirjen e efekteve kohore të këtyre amendimeve edhe për një vit tjetër, por në asnjë takim nga Albtelecom nuk është përmëndur se qëndrimi i tyre ishte për një kohëzgjatje disa mujore siç përmëndet në ankesën e Albtelecom se priten ndryshime nga ana e AKEP në bazën rregullatore;

- AMC e konsideron të papranueshme dhe aspak praktike nje logjike të tille nga Albtelecom, e cila nëse do të gjente zbatim do të kërkonte lidhjen e MI në intervale shumë të shkurtra kohe ku do të çenohej parimi i sigurisë juridike;
- AMC, thekson se është e pa arësyeshme që kohëzgjatja e këtyre ndryshimeve të lidhej me ndryshimet e supozuara nga AMC për kuadrin rregullator të AKEP, në kushtet kur forma dhe koha e nxjerrejs së tyre nuk mund të parashikohen në asnjë rast;
- AKEP në përmbushje të detyrimeve të tij ligjore, mund të nxjerrë dhe priten vendime të reja apo rregullime në çdo kohë duke patur parasysh dinamikën e zhvillimit të sektorit dhe tregjeve përkatëse;
- Por kuadri ligjor në vend e ka zgjidhur qartë mënyrën e zbatimit të këtyre vendimeve dhe në asnjë rast nuk kushtëzohet nga ekzistenca e marrëveshjeve ne fuqi dhe kohëzgjatja e tyre. AMC, sa herë që janë ndryshuar tarifat apo kushte të tjera, i ka reflektuar këto ndryshime në marrëveshjet përkatëse me partnerët e saj;
- AMC thekson se kërkesa për nënshkrimin një amendamenti me kohëzgjatje vetëm disa mujore, vështirëson zbatimin e termave të RIO, e cila të gjitha referencat veçanërisht ato që kanë të bëjnë me llogaritjen e garancisë janë në terma 1 vjeçare;

Mbi bazën e diskutimeve dypalëshe në të dy takimet e bëra, AMC ka ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- a) AMC më datë 14.05.2010 i dergon Albtelecom një draft të amendimit të MI nga data **01.04.2010 deri 31.08.2011**. AMC thekson se në këtë draft ka përfshirë paragrafin “*Tarifat e shërbimeve të trafikut të dhëna në gjermën a) të pikës 1 janë në përputhje me VKM nr. 853, datë 18.06.2008, përse këto akte normative i shtrijnë efektet e tyre në kohë*”(Bashkëlidhur drafti i MI);
- b) Albtelecom më datë 19.05.2010 është përgjigjur duke bërë ndryshime që preknin MI, për te cilën ishte rënë dakort që MI nuk do të ndryshonte, por do te bëhej një amendament vetëm për zgjatjen e afatit kohor per 1 vit të saj, dhe të gjitha klauzolat e tjera do të mbeteshin të pa ndryshuara. Afati i propozuar nga Albtelecom ishte 01.04.2010 deri 31.08.2010 dhe jo siç ishte rënë dakort në dy mbledhjet e mëparshme për një afat 1 vjeçar;
- c) Ne vijim te negociatave AMC është përgjigjur duke marre ne konsiderate çfarë ishte ndryshuar nga MI ekzistuese, duke bërë disa saktësime dhe korigjime të mëtejshme;
- d) Albtelecom vetëm më datë 21.06.2010 ka paraqitur një shkresë në të cilën bën përsëri ndryshime në afatin kohor te MI tashmë **01.04.2010 deri 31.10.2010**, si dhe në kuadrin ligjor, shkresë e cila shoqërohej me një draft të firmosur dhe të vulosur nga Albtelecom pa marrë parasysh asgjë nga drafti i propozuar nga AMC, duke e venë AMC para faktit të kryer;

- e) Së fundmi AMC me anë të shkresës nr.3341/2 prot, dt. 09.07.2010 në përgjigje të draftit të Albtelecom i bashkëngjiti draftin me kërkesat e saj si me poshte vijon:
- Amendamenti duhet të përfshijë afatin kohor të një viti duke filluar nga 1.04.2010 deri 31.03.2010.
  - Bazuar në ligjin e komunikimeve elektronike, RIO, Rregulloren për akses dhe interkoneksion si dhe në marrëveshjen e interkoneksionit të ndertuar mbi RIO, çdo sipërmarrës në një marrëdhënie interkoneksioni duhet të shlyej detyrimet e tij sipas nenit 22 të MI dhe neni 9 i Rregullere për akses dhe interkoneksion;
  - Për sa më sipër AMC kërkon të shtohet paragrafi me poshte, “Albtelecom pranon se në datën e nënshkrimit të këtij amendamenti, ka një detyrim të pa shlyer ndaj AMC në periudhat e mëparshme në shumën (Përfshirë dhe interesat e akumuluar deri në këtë datë) të cilën zotohet ta shlyej në mënyrën e përcaktuar në Aneks (bashkëngjitur data dhe afatet e përcaktuara aty), në qoftë se Albtelecom nuk i përmbush këto detyrime në mënyrën dhe afatin e përcaktuar, AMC i lind e drejta të kërkojë pagimin e garancisë bankare sipas paragrafit, duke i konsideruar këto shuma si mos përmbushje të MI. AMC ka të drejtë të zbatojë të gjitha dispozitat e kësaj MI në rast mospërmbushje të këtyre detyrimeve sipas mënyrës dhe në afatin e përcaktuar në Aneksin bashkëngjitur”;
- f) AMC thekson se nga ana e saj edhe pas ankimit të Albtelecom, përpjekjet për nënshkrimin e amendamentit të MI vazhduan duke lënë një takim me Albtelecom i cili u anulua nga Albtelecom. AMC në shkresën nr. 3341/2 prot, dt 09.07.2010 drejtuar Albtelecom i konfirmon kesaj të fundit se AMC është në pritje të një takimi të ri mbi çështjen në fjalë;
- g) AMC, gjykon se nuk ka asnjë arsye pse Albtelecom të kërkojë një trajtim të ndryshëm nga operatorët e tjerë për sa i përket likuidimit paraprak të detyrimeve të prapambetura në kushtet e rinovimit të afatit të MI apo gjatë kohës së zbatimit të saj, ndërkohë shpreh gadishmërinë e saj për të nënshkruar shtesën e kohëzgjatjes së MI me Albtelecom, si zgjidhja më optimale që nuk kërkon investim të mëtejshëm,
- h) Gjithashtu AMC nëpërmjet shkresës nr. 2297/13 Prot, dt. 06.09.2010, informon AKEP se në lidhje me problemet teknike që kanë të bëjnë me lidhjet ndërkombëtare midis AMC dhe Albtelecom, se Divizioni Teknik i AMC po bën progres dhe të gjitha lidhjet do të rivendosen jo më vonë se sot. Për sa më sipër AMC konsideron se Albtelecom nuk dëshiron të ketë një marrëveshje, duke qënë se kjo e ekspozon Albtelecom ndaj përgjegjësive financiare siç janë lëshimi garancive dhe kryerja e pagesave;

2. **Albtelecom sh.a**, me anë të shkresës nr. 3758/1 prot, date 24.08.2010 (AKEP: nr.2481/5 datë 24.08.2010), “Mbi depozitim të pretendimeve të Albtelecom lidhur me AMC për

përfundimin e afatit të vlefshmërisë dhe rinovimin e MI” (Bashkelidhur gjendet korrespondenca me email mbi amendamentin nr.1 të MI midis palëve), sqaron se:

- Albtelcom ka filluar negociatat me AMC që në mars 2010, e cila është në tejkalim të afateve për të shprehur vullnetin e saj për të vazhduar negociatat, pasi dështimi i procesit të negociatave është një fakt që evidentohet ose konstatohet dhe nuk kushtëzohet nga dakortësia e palëve për ta quajtur procesin të tillë;
- Albtelcom ka shprehur vullnetin e tij për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë deri më 31.10.2010 pra 2 muaj më shumë se qëndrimi i Albtelcom i shprehur në korrespondenca të tjera me AMC;
- Albtelcom në lidhje me firmosjen e amendamentit sqaron se ai është firmosur dhe vulosur nga Albtelcom thjesht për aspektin procedurial, fakt i cili vërtetohet edhe nga shkresa me lëndë “Mbi dërgimin e *propozimit* të Albtelcom për amendimin e MI”;
- Albtelcom në lidhje me ndryshimet e marrëveshjes ekzistuese sqaron se është shprehur vetëm për saktësime në përputhje me RIO-n e AMC të disa dispozitave ekzistuese, pasi Albtelcom ka hasur disa herë në pengesa për zbatimin e tyre, gjithashtu Albtelcom ka qënë vazhdimisht dakort për rinovimin apo shtyrjen e afatit, por në asnjë rast Albtelcom nuk është shprehur në favor të shtyrjes një vjeçare të vlefshmërisë së MI;
- Në vijim të qëndrimit të mbajtur në shkresën nr. 3069 prot, dt 30.06.2010 drejtuar AKEP, Albtelcom rithekson rëndësinë dhe impaktin që kanë aktet rregullatore në MI mes palëve, dhe pikërisht pritshmëria për miratimin dhe konkludimin e shpejtë të dokumenteve si Analiza e Tregjeve, Vendimet për koston e shërbimeve dhe përditësimet në RIO, përbëjnë argumentin qëndror të Albtelcom për shtyrjen MI aktuale për një periudhë disa mujore, periudhë e cila përputhet me afatet tranzitore të implementimit të detyrimit të OFNT-ve për të publikuar RIO-t;
- Altelcom konsideron se AKEP për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje duhet të përfshijë në Vendim përfundimtar të tij, elementet si më poshtë vijojnë:
  - i. Tarifë të arsyeshme terminimi në rrjetin e AMC per të cilën konsideron se:
    - Tarifa e terminimit në rrjetin mobile referuar VKD nr.1345 datë 23.07.2010 i KD të AKEP është një tarifë tavan maksimale;
    - Referuar modelit të BU\_LRAIC mbi llogaritjen e kostove të shërbimeve celulare evidentohet se këto tarifa janë me shumë se 2 herë më të larta se kostot e tyre;
    - Tarifat sipas dokumenteve rregullator të AKEP duhet të orientohen drejt kostove;
    - Nuk ekziston asnjë arsye ligjore që të ligjitimojë subvencionimin e shërbimeve të AMC nga Albtelcom permes pagesave të larta për shërbimin e terminimit të thirjeve në rrjetin AMC;

Për sa më sipër Albtelecom kërkon që tarifa e terminimit në AMC të jetë në përputhje me koston e ofrimit të shërbimit të terminimit në rrjetin e AMC.

- ii. Shërbim terminimi mbi baza jodiskriminuese të cilën e bazon në:
- Praktikën europiane dhe angazhimeve të Shqipërisë në kuader të MSA dhe OBT;
  - Praktikën për mirëstabilizimin e ofrimit të shërbimeve të terminimit dhe tranzitimit në RSH;
  - Parimit të ligjit për komunikimet elektronike për mos diskriminim sipas nenit 39 të ligjit, dhe parimit për orientimin e tarifave drejt koston sipas nenit 45 të ligjit;
  - Vendimeve të Gjykatave lidhur me terminimin e trafikut ndërkombëtar;
  - Dokumentit Rregullor për analizën e tregut ;
  - VKM nr. 853 dhe 854 datë 18.06.2008;

Për sa më sipër, Albtelecom thekson se edhe në negociata komerciale për tarifën e terminimit, do të pranojë si tarifë vetëm tarifën e orientuar në kosto eficiente të ofrimit të këtij shërbimi nga ana e AMC;

Gjithashtu Albtelecom konsideron se AKEP në kuadër të zgjidhjes së kësaj mosmarrëveshjeje nëpërmjet një Urdhëri për lidhjen e MI së re, të përcaktohet tarifa e terminimit të të gjitha kategorive të thirrjeve në rrjetin AMC;

Albtelecom konsideron se MI e re nuk mund të kushtëzohet nga mosmarrëveshje dhe rrethana të tjera, të cilat janë zgjidhur apo po zgjidhen sipas procedurave ligjore në fuqi në RSH, apo marrëdhënieve kontraktuale të mëhershme midis AMC dhe Albtelecom;

Albtelecom thekson se gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së MI nr. 5800/1 dt 29.07.2009 deri më sot ka përmbushur sistematikisht detyrimet e veta dhe kur është bërë e nevojshme është aktivizuar dhe rinovuar garancia e Albtelecom brënda kushteve dhe termave të marrëveshjes së fundit;

Për më tepër kjo situatë ka vijuar edhe pasi AKEP i është drejtuar AMC me shkresën nr. 2297/9 prot, datë 18.08.2010 “Mbi rilidhjen e qarqeve të interkoneksionit mes AMC sh.a dhe Albtelecom sh.a”,

3. Më datë 5.10.2010, Komisioni i Zgjidhjes së kësaj Mosmarrëveshjeje zhvilloi një senacë dëgjimore me AMC dhe Albtelecom. Gjatë senacës dëgjimore secilapalë mbrojtësit pozicionet e veta të shprehura në pretendimet me shkrim. Palëve ju kërkua që të depozitonin në AKEP çdo pretendim apo prova të tjera që mbështesnin argumentat e tyre.
4. Albtelecom nëpërmjet shkresës nr.4696, datë 15.10.2010 (AKEP: nr. 2297/23, datë 18.10.2010) “Mbi shtim objekti për mosmarrëveshjen me AMC lidhur me rinovimin e MI dhe dërgimin e provave shkresore në vijim të seancës dëgjimore mbajtur në AKEP në



kuadër të VKD 1353 dt. 06.08.2010”, sqaron se duke u ndodhur në situatën që janë ezauruar të gjitha rrugët për zgjidhjen në mirëkuptim mes palëve, **kërkon ndërhyrjen e AKEP lidhur me tarifën e shërbimit të terminimit të trafikut ndërkombëtar në rrjetin e AMC** bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9918 datë 19.05.2010 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”. Albtelecom thekson se nuk ka patur asnjë ofertë për tarifën e terminimit nga AMC , dhe asnjë ofertë për negociim edhe pse ka bërë të gjitha përpjekjet siç parashikohet në kuadrin rregullator për të patur mundësinë për të negociuar mbi këtë tarifë. Albtelecom i ka bashkangjitur kësaj shkrese, komunikimet midis Albtelecom dhe AMC për çështjen e tarifës së terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, problemet me cilësisinë e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare dhe korrespondencën për shlyerjen e borxhit të Albtelecom ndaj AMC. Për sa më sipër Albtelecom thekson se, duke parë qëndrimin e AMC është e domosdoshme ndërhyrja e AKEP lidhur me tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e AMC si një nga termat thelbësorë të MI, gjithashtu edhe për përcaktimin e qartë të të gjitha termave të tjerë të ofrimit të këtij shërbimi;

5. Në lidhje me çështjen e borxhit të Albtelecom ndaj AMC;
  - i. Albtelecom njeh borxhin që ka ndaj AMC dhe midis palëve ka pasur korrespondenca (dërguar edhe AKEP) dhe takime për shlyerjen e tij nga Albtelecom;
  - ii. Nga korrespondenca midis palëve të dërguara nga Albtelecom me shkresën nr.4696, datë 15.10.2010, vihet re se:
    - AMC me shkresën nr. 1054/15Prot., datë 17.09.2010, dërguar Albtelecom (për dijeni AKEP), kujton Albtelecom për shlyerjen e borxhit, duke cituar se beson që Albtelecom do të respektojë planin e shlyerjes siç është diskutuar dhe rënë dakort gjatë muajit Maj 2010 dhe gjithë korrespondencës së metejshme. AMC rikujton Albtelecom se asnjë pagesë nuk është kryer që prej datës 26.07.2010., dhe se në rast se nuk kryhet shlyerja e detyrimeve brënda datës 30.09.2010, ajo do të konsiderohet mosrespektim i negociatave për planin e shlyerjes dhe AMC do të vazhdojë të llogarisë intersat për faturat e pashlyera;
    - Albtelecom me shkresën nr.4300/1 Prot, datë 28.09.2010, konfirmon rënien dakort për planin e Shlyerjes sipas diskutimeve në mbledhjen e datës 22.05.2010, që është konfirmuar nga Albtelecom më 22.06.2010 dhe nga AMC më 13.08.2010.
    - Albtelecom me shkresën nr.4511 Prot, datë 3.10.2010, konfirmon përsëri anagzhimin për respektimin e Planit të Shlyerjes dhe në vijim të tij është paguar kësti për muajin shtator 2010 prej \_\_\_\_\_lekë.

**II.** Për sa më sipër si edhe nga seanca dëgjimore midis palëve i mbajtur më datë 05.10.2010, AKEP konstaton se:

1. Në lidhje me afatin e marrëveshjes së re apo amendimit të marrëveshjes së interkoneksionit midis AMC dhe Albtelecom:
  - i. AKEP ka diskutuar me sipërmarrësit (me FNT dhe alternative) në lidhje me përcaktimin e RIO-ve dhe MI-ve aktuale në lidhje me afatin e MI-ve midis operatorëve në treg. Përcaktimi final i AKEP për këtë çështje do të bëhet me vendimet për miratimin e RIO-ve të reja të operatorëve me FNT, të cilat aktualisht janë në shqyrtim nga AKEP. Miratimi nga AKEP i RIO-ve të katër operatorëve me FNT do t'i hapë rrugë lidhje së marrëveshjeve të reja të interkoneksionit midis operatorëve.
  - ii. Për shkak të ndryshimeve të ndodhura në treg, Rregullores së aksesit dhe Interkoneksionit si dhe Vendimeve të AKEP për FNT, përfshirë për AMC dhe Albtelecom), marrëveshjet e reja të interkoneksionit që do lidhen midis palëve në treg do të duhet të reflektojnë këto ndryshime si dhe përcaktimet e RIO-ve të përmedura më lart, të cilat kërkojnë miratimin nga AKEP.
  - iii. AKEP gjykon se zgjidhja më e mirë është lidhja e MI-se se re nepermjet nënshkrimit të saj nga palet mbi terma ligjore dhe kontraktual.
  
2. Në lidhje me çështjen e borxhit të Albtelecom ndaj AMC:
  - i. Nga komunikimet vihet re se Albtelecom njeh borxhin e pashlyer dhe palët nuk kanë mosmarrëveshje në lidhje me llogaritjen apo vlerën e tij, çka mund të kërkonte ekspertizën dhe/ose vendim-marrjen e AKEP. Palët rezultojnë se kanë mosmarrëveshje për mënyrën e shlyerje së tij, për këtë duket se palët kanë rënë dakort në një plan shlyerjeje, që ka filluar të paguhet nga Albtelecom.
  - ii. Duke qene se;
    - Modalitetet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve financiare midis sipërmarrësve parashikohen në marrëveshjet e interkoneksionit të nënshkruara nga vete palët;
    - AKEP, duke mos paraqitur ndonjë qëndrim ndryshe nga ai i pranuar nga vete palët, e ka pranuar në këtë mënyre vullnetin e palëve për këtë çështje;
    - Sipas nenit 690 të Kodit Civil, kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët;
    - AKEP sipas praktikave të deritanishme nuk ndërhyr midis paleve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të karakterit financiar por i orienton ato në zgjidhjen e tyre në mirkuptim dhe në rast të kundërt të ndjekin rrugë alternative ligjore ( arbitrazhin ose shqyrtimin gjyqësor)

Atehere edhe për këtë rast për zgjidhjen e mosmarrëveshjes lidhur me çështjet e pagesave, AKEP i orienton palët për zgjidhjen e saj në mirkuptim dhe në rast të

kundert nepermjet rrugeve alternative ligjore – ndermjetesimit dhe arbitrazhit ose shqyrtimit gjyqesor.

3. Në lidhje me problemet për qarqet e trafikut ndërkombëtar:
  - i. Problemet evidentuara nga Altelecom me cilësinë e trafikut hyrës ndërkombëtar të terminuar në rrjetin AMC, në lidhje me treguesin ASR, AKEP synon ti zgjidhë përmes përmirësimit të përcaktimeve në RIO-t e reja që janë në shqyrtim nga AKEP;
  - ii. Ndërkohë është rëndësishme që palët të shkëmbejnë treguesit e ASR për thirrjet e terminura në rrjetet respektive, edhe për trafikun e përcjellë nga operatorët e tjerë:
4. AMC dhe Altelecom janë operatorë të cilët kanë një numër të madh të përdoruesve të rrjeteve të shërbimeve të komunikimeve elektronike në telefoninë celulare dhe fikse, respektivisht, dhe vazhdimi i marrëdhënieve normale të interkoneksionit midis tyre ka rëndësi të vecantë për përdoruesit e rrjeteve të tyre si dhe për të gjithë tregun në tërësi.

#### **P Ë R K Ë T O A R S Y E :**

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 140 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brëndshme,

#### **V E N D O S :**

1. Të mbyllë procedimin administrativ të filluar me VKD nr. 1329, datë 15.07.2010 për zgjidhje mosmarrëveshje interkoneksioni midis sipërmarrësve Altelecom sh.a dhe Albanian Mobile Communications sh.a.;
2. Albanian Mobile Communications sh.a dhe Altelecom sh.a të lidhin marrëveshje interkoneksioni sipas përcaktimeve të Urdhërit bashkëngjitur;
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)  
Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

**ANËTARËT:**

**1. Alketa MUKAVELATI**

**2. Benon PALOKA**

**3. Ibsen ELEZI**

**4. Zamira NURÇE**